

Fjalë  
(74 VJET TË BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË KOSOVËS)

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit - z. Kujtim Gashi,

E nderuara Kryetare e Këshillit Drejtues të Bibliotekës - znj. Sazan Çapriqi

I nderuar Këshilltar i Kryeministrit të Kosovës - z. Jahja Lluka

I nderuar Rektor i Universitetit të Prishtinës - z. Marjan Dema,

I nderuar Kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë - z. Hydajet Hyseni,

I nderuar Besim Kokollari, përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Kosovë,

të nderuar profesorë, drejtues të bibliotekave publike të Kosovës, të nderuar kolegë bibliotekarë, bibliotekarë që tashmë keni përfunduar karrierën, sot Biblioteka Kombëtare e Kosovës, në një kremtim dhe aktivitet të përbashkët me Shoqatën e të Burgosurve Politikë, që është ekspozita me fotografi e dokumente: Kujtesa e Kosovës: Demonstratat shqiptare të '68-tës, kremton 74-vjetorin e themelimit të këtij institucioni që është qendër e Kujtesës së Kosovës për materialet bibliotekare.

Më lejoni që sot para jush, në 74-Vjetorin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, të jap një përshkrim të shkurtër të punëve dhe projekteve, por edhe të sfidave të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, si institucion bibliotekar qendror dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar, e cila mbledh, përpunon dhe ruan materialet bibliotekare me vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën, në veçanti të Kosovës.

Ndërsa festojmë 18 vjet të lirisë së Kosovës dhe 74 vjet histori të veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, ne që punojmë në bibliotekë, kemi detyrën për të siguruar që të përshpejtojmë strategjitë tona për grumbullimin dhe ruajtjen e materialeve që botohen e shtypen në Kosovë, por edhe jashtë saj, por edhe për t'u siguruar se po hyjmë në një proces digjitalizimi me të cilin po rrisim cilësinë e shërbimeve në dhënien e qasjes përdorueseve në materialin e leximit.

Edhe pas kaq vitesh pas luftës, me siklet, por duhet ta pranojmë, vijojmë të përballemi me probleme të mëdha e të vogla, me probleme që i kuptojmë dhe me probleme

kinse i kuptojmë. Dhe, në këto sfida jemi të thirrur të pranojmë përgjegjësitë tona para se të kërkojmë fajtorë. E, përgjegjësitë tona përkojnë me hapat që duhet të ndërmarim për një strategji të përpiktë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale, të dijes në fushën e bibliotekarisë e të shkencave të informacionit. Sepse, do dhe mund dhe dije për të kuptuar, që më pas për të vepruar, në sfidën tonë të sotshme që kanë gjithë bibliotekat nacionale, si t'i përpunojmë e menaxhojmë koleksionet gjithnjë në rritje të bibliotekës, që vijnë ose do të vijnë prej të gjitha anëve e të lloj-llojshme. Brenda një procesi të tillë, nuk mund të reshtin shqetësimet për të gjetur shtegun për t'u zgjidhur ndofarë situatash, që janë realitet i bibliotekave nacionale dhe i punëtorëve të tyre që sfidohen me realitetin e një reagimi kur thonë: 'kuku - sa materiali po hyn në bibliotekë - si ta ruajmë e përpunojmë' apo tjetra 'kuku se si askush nuk po i dorëzon bibliotekës materialet e botuara e elektronike'. Në rastin tonë, meqë Biblioteka Kombëtare e Kosovës, me ligjin për bibliotekat, është qendër e marrjes dhe e depozitimit të kopjes së detyrueshme, e kultura e dija e Kosovës e ka urgjente grumbullimin dhe ruajtjen, u bëjmë thirrje të gjithë botuesve të materialeve të shtypura e grafike, atyre që bëjnë publikimet zyrtare, riprodhimet e veprave të artit vizual, riprodhimet e veprave hartografike, fotodokumenteve e fonodokumeneteve, regjistrimeve pamore etj., që t'ia dorëzojnë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, për ta ruajtur kulturën e Kosovës. Ne kemi edhe zotimin e Ministrit të Kulturës - z. Gashi, se Bibliotekës Kombëtare të Kosovës do t'i ofrohet siguri në mbrojtjen e koleksioneve, duke mënjanuar problemet që ka biblioteka me krijimin e sigurisë për ruajtjen e këtyre koleksioneve.

Të nderuar të pranishëm,

më lejoni, pa e zgatur shumë, të japë disa nga projektet që Biblioteka Kombëtare e Kosovës i ka realizuar apo është në proces të finalizimit të tyre dhe të cilat na japin zemër dhe besim për punë të mbarë, por të cilat nuk do të merrnin këtë rrjedhë pa mbështetjen financiare të tyre. Për cilat është fjala?

E para:

Bibliografia retrospektive e librit shqip të botuar në Kosovë përgjatë viteve 1912-1999, që është bibliografi që do të përfshijë të gjitha botimet përgjatë këtyre viteve në Kosovë, por edhe jashtë saj, sidomos në një periudhë kohore rreth një shekulli, kur Kosova ka qenë nën pushtimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, pastaj njësi Federative brenda shtetit të ish-Jugosllavisë, i cili projekt po përkrahet nga Ministria e Kulturës dhe në të cilin po punojnë një staf i zgjedhur i Bibliotekës Kombëtare, i Qendrës së Bibliotekës Universitare, si dhe mbi dhjetë veta jashtë bibliotekës autorë, botues e veprimtarë të njohur - njohës të mirë të historisë së botimeve shqip. Qëllimi i këtij projekti është luftimi i harresës së librit shqip, rievualimi i tij dhe shndërrimi i tij në mjet të përdorimit të përditshëm e bashkëkohor për dijetarët e fushave të ndryshme në nivel nacional e internacional. Qëllimi i këtij projekti do të jetë konsolidimi kulturor e shkencor i informatës, e cila është parakusht i çdo ndërmarrjeje tjetër shkencore, qoftë e nisur nga individë studiues, studentë apo edhe grupe të ndryshme të hulumtuesve shkencorë nëpër institucionet e Kosovës dhe jashtë saj. Pra, do të hartohet një bibliografi kombëtare, gjithëpërfshirëse, me formë dhe strukturë të bazuar në rregulla dhe standarde bibliografike, që përfshin botimet e librit shqip në arealin shqiptar të Kosovës dhe në afri më të në periudhën 1912 - 1999.

E dyta:

“Kujtesa e Kosovës: Histori gojore - 100 rrëfime nga 100 pleq e plaka”, projekt i hartuar dhe i realizuar nga profesorë e studentë të Degës së Antropologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në të cilin janë të angazhuar dy profesorë, 15 studentë dhe dy bibliotekarë. Faza e parë e këtij projekti - regjistrimi dhe grumbullimi i 100 intervistave është financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë (që është njëri nga partnerët më besnik në përkrahjen dhe avancimin e punës në Bibliotekën Kombëtare dhe në Këndin Amerikan), ndërsa që fazën e dytë - transkriptimin e intervistave tashmë të mbledhura, është duke e përkrahur Ministria e Kulturës. Projekti ka për qëllim të mbledhë, të dokumentojë, të publikojë dhe të promovojë historitë gojore të personave të moshuar të Kosovës, më të vjetër se 80 vjeç. Me këtë projekt, synohet të krijohet Arkivi i historisë gojore në Qendrën “Kujtesa e Kosovës”, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Qendër kjo si një

rrjet i fortë ndërmjet Bibliotekës Kombëtare, Bibliotekave Lokale dhe Rajonale, Departamentit të Antropologjisë dhe hulumtuesve shoqërorë me qëllim që të mbledhin dhe dokumentojnë vazhdimisht historitë gojore të popullit të Kosovës në të ardhmen.

E treta:

Biblioteka Kombëtare, si bartëse e drejtpërdrejtë e ruajtjes së trashëgimisë së dokumentuar intelektuale, do të nisë në fund të dhjetorit projektin e Bibliotekës digjitale, një projekt i shtyrë deri më tash për shkak të një sërë problemesh teknike që e kanë përcjellë. Me anë të këtij projekti, biblioteka do të kontribuojë në ruajtjen dhe konservimin e kësaj pasurie në radhë të parë, si dhe të vënies në dispozicion të secilit në çdo kohë dhe në çdo vend nëpërmjet teknologjisë së informacionit.

Në aspektin praktik, BKK është pajisur me përkrahjen e Ministrisë së Arsimit me pajisje digjitale të skanimit me rezolucion të lartë. Na duhet që tashmë, për këtë të punësojmë dhe të trajnojmë njerëz që janë të aftë të bëjnë punë të madhe. Dhe sfida e madhe vjen nga fakti se, jemi të vetëdijshëm, se sa më shumë njerëz që po përdorin ueb-in për të hyrë në burimet e bibliotekës, aq më e madhe po bëhet joshja për të vizituar hapësirat fizike të bibliotekave. Pra, kjo do të thotë që neve tashmë nga këtu e tutje, na duhet, jo pak, por shumë investime në shërbimet tona virtuale, ndërsa që fillimi i kësaj punë do të jetë një festë frymëzuese, për të bërë një kthesë të rëndësishme në shënim të këtij 74-vjetori të bibliotekës.

E katërta:

Programi Fulbright për zhvillim të programit për arsimim bibliotekar. Biblioteka Kombëtare ka përfituar nga aplikimi me një projekt në Ambasadën Amerikane në programin Fulbright, duke mundësuar ardhjen nga SHBA në Kosovë të njërit nga ligjëruesit e shkencave të informacionit e të bibliotekarisë, i cili do të punojë për rreth një muaj me drejtues të bibliotekave publike dhe udhëheqës departamentesh, për zhvillimin e një programi të arsimimit bibliotekar, shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm për aftësimin e bibliotekarëve të Kosovës, atë që e përmenda dhe sipër si nevojë, e i cili program do të jetë i aplikueshëm gjatë vitit 2019.

E pesta:

Përkon me projektet e investimeve në fushën e infrastrukturës. Fjala është për ndërrimin e klima-komorave. Me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, këtë vit është vendosur pjesa tjetër e sistemit të ri të ngrohjes dhe ftohjes së objektit të BKK, me të cilin sistem të ventilimit që ofron ngrohje/ftohje, u ofrohen kushte të përshtatshme edhe lexuesve për të lexuar edhe punëtorëve për të punuar.

Ato që dua t'i theksoj si projekte nga të cilat Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka përfituar nga një partneritet publiko-privat, janë ai me:

- Kompaninë NESTLE, fushatën "Start Smat" të kompanisë Nestle, me të cilën është siguruar një hapësirë moderne për përdorues, për t'u shoqëruar dhe për t'u zhvilluar profesionalisht, për të pasur qasje në burime elektronike, por edhe për të organizuar punëtori dhe trajnime si dhe për edukimin përmes projeksioneve filmike;

- Dhe, po ashtu projektin në të cilin është përfituar donacion nga IPKO, e cila ka pajisur një kënd për pushim i përdoruesve, duke rinovuar dhe pajisur me ndenjësë, tavolina, internet për wireless, karikues për telefon, kënd për lexim e shfletim të lirë të librave, një vend shumë i rehatshëm për t'u ndjerë mirë.

Të nderuar të pranishëm,

këto ishin projektet që nga nëntori i vitit të kaluar në këtë nëntor janë ose po realizohen të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, ndërsa që krejt në fund dua të them, në këtë përvjetor se me gjithë hakun që e kemi për të na qortuar ne bibliotekarëve, për të qenë në lartësinë e sfidave në të cilat jemi të thirrur dhe që duhet t'i përballojmë në punën tonë profesionale, është sflitëse ta inkurajosh sot bibliotekarën e dijshtëm të punojë me pagën që ka. Ata janë të shqetësuar dhe të hutuar. Ne e kemi këtu ministrin Gashi që të mund të shpresojmë për ta bërë më të mirën për punëtorët e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.

Faleminderit!